

Nr. 117 Prot

Tirane, me 22.10.2024

DREJTUAR: Agjensise se Mbikeqyerjes se Falimentimit

OBJEKTI: Kthim Pergjigje e-mail date 30.09.2024

U njohem me email-in Tuaj te dates 30.09.2024 me ane te cilit Ju kerkoni informacion referuar procedures se falimentimit te shoqerise "Besa Agro Invest " sh.p.k, kreditoreve te likujduar dhe shumave perkatese. Ju sqaroj si me poshe vijon.

Ne pergjigje te email-in Tuaj Ju sqaroj se sipas Vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane me Nr.Akti 8762, date 04.03.2024 vendim i cili ka marre forme te prere eshte vendosur hapja e procedures se falimentimit te shoqerise "Besa Agro Invest " sh.p.k (NIPT: L41726002A),duke me emeruar mua, Znj. Shpresa Breçani si Administratore Falimentimi per kete shoqeri sipas percaktimeve te Ligjit Nr. 110/2016 "Per Falimentimin".

Ne permbushje te detyrave te caktuara nga Gjykata e Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane, ne zbatim te Ligjit Nr.110/2016 "Per falimentimin", te Standardeve Kombetare per Administrimin e Mases se Falimentimit miratuar me VKM Nr.733, date 13.11.2019 si dhe ne zbatim te funksionit te Administratores se Falimentimit, kam ndjekur procedurat e falimentimit te shoqerise.

Duke filluar nga data efektive e marrjes se detyres e deri ne keto momente veprimet me te rendesishme te ndermarra nga ana ime perfshijne ne menyre permbledhese:

- Dergimi i njoftimit te emerimit tim si Administratore Falimentimi per shoqerine "Besa Agro Invest" sh.p.k te gjitha Bankave te nivelit te dyte ne lidhje me gjendjen e llogarive bankare te shoqerise, natyren e transfertave te bera nga bankat;



- Njoftimin e dates 11.07.2024 afishuar ne ambientet e selise se shoqerise per punonjesit/ish-punonjesit, kreditorët e shoqerise “Besa Agro Invest” sh.p.k per depozitimën e pretendimeve brenda 45 diteve nga shpallja e ketij njoftimin dhe kerkese per debitorët per shlyerjen e detyrimeve ndaj shoqerise prane administratores se falimentimit (*publikuar ne <https://albanianbis.com/wp-content/uploads/2024/09/Njoftim-Besa-Agro-Invest-per-pretendimet-e-kreditoreve-11.07.2024-.pdf>*)
- Dergimi i njoftimit te emerimit tim si Administratore Falimentimi per shoqerine “Besa Agro Invest” sh.p.k te gjitha Drejtorive Rajonale te ASHK-ve per Pasurite e Paluajtshme dhe te pasurive te luajtshme (RBS);
- Hartimi i listes se kreditoreve dhe debitorëve
- Verifikimin , pranimin e pretendimeve te paraqitura nga kreditorët dhe debitorët
- Inventarizimi i asetëve/inventarit fizik ne pronesi te shoqerise ne sasi dhe vlere me vendodhje ne ambientet e shoqerise
- Verifikimi i inventarit kontabel te pasqyruar ne pasqyrave financiare te shoqerise
- Kontaktimi i paleve te treta (perfshire punonjesit dhe perfaqesuesin e tyre) te cilet kane dhene informacione te detajuara te shoqerise ne procedure falimenti
- Kam depozituar prane Qendres Kombetare te Biznesit kerkesen me Nr.100 Prot, date 29.07.2024 per te ndryshuar adresen kryesore nga ajo ku ka zhvilluar aktivitetin shoqeria ne menyre qe korrespondenca te kaloje nepermjet Administratores se Falimentimit ,por nga ana e QKB nuk eshte kryer ndryshimi me arsyetimin se duhet te aplikojme online ne portalin e-albania.

Ju bej me dije se Vendimi i Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane me Nr.Akti 8762, date 04.03.2024 vendim i cili ka marre forme te prere, eshte publikuar ne:

1. Fletoren Zyrtare te Republikes se Shqiperise me Nr.114, date 04.07.2024 (<https://qbz.gov.al/eli/vendim-i-shkurtuar/2024/03/04/8762/c404a1c2-bf31-4f72-aed3-8dbbdf44ca47;q=besa%20agro%20invest>)
2. Me shkresen Nr.8997/2 Prot, date 10.07.2024 Qendra Kombetare e Biznesit me komunikon se eshte miratuar aplikimi i kryer nga ana ime per te depozituar vendimin e gjykates per hapjen e procedures se falimentimit te shoqerise “Besa Agro Invest” sh.p.k



3. Ne web site albanianbis.com eshte publikuar e Vendimi i Gjykates se Shkalles se Pare te Juridksionit te Pergjithshem Tirane me Nr.Akti 8762, date 04.03.2024 per hapjen e procedures se falimentimit te shoqerise “Besa Agro Invest” sh.p.k (<https://albanianbis.com/2024/06/03/vendim-per-celjen-e-procedures-se-falimentimit-te-shoqerise-besa-agro-invest/>)

Ne daten 27.09.2024 eshte depozituar prane Gjykates se Shkalles se Pare te Juridksionit te Pergjithshem Tirane raportimi i administratores se falimentimit referuar ecurise se veprimeve te procedures. Ne kete raportim jane identifikuar edhe lista e ish-punonjesve qe kane paraqitur pretendimet dhe nga verifikimi i kryer nga ana ime me rezulton se ish-punonjesja Znj. Erjola Mecuku nuk ka depozituar pretendimet prane administratores se falimentimit.


Referuar dispozitave ligjore te parashikuara ne Ligjin 110/2016 “ Per Falimentimin” ish-punonjesja mund ti paraqesi pretendimet e saj te cilat ne baze te Nenit 92 do te klasifikohen si pretendime te paraqitura me vonese.

Bashkelidhur, gjeni:

1. Nje kopje te Vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare te Juridksionit te Pergjithshem Tirane me Nr.Akti 8762, date 04.03.2024
2. Njoftimin e dates 11.07.2024 afishuar ne ambientet e selise se shoqerise per punonjesit/ish-punonjesit, kreditoret e shoqerise “Besa Agro Invest” sh.p.k
3. Nje kopje te Fletores Zyrtare te Republikes se Shqiperise me Nr.114, date 04.07.2024
4. Shkresen Nr.8997/2 Prot, date 10.07.2024 te Qendres Kombetare e Biznesit

Me respekt,

Administratore Falimentimi
Shpresa BREÇANI





www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 114

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 4 korrik 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 26.6.2024	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Elbasanit.....	13795
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 3190/16, datë 14.6.2024	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	13795
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 2819, datë 27.6.2024	Për refuzimin e ankimit administrativ të subjektit “Micro Credit Albania” sh.p.k.	13795
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 2820, datë 27.6.2024	Për refuzimin e ankimit administrativ të subjektit “Final” sh.p.k.....	13798
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 100, datë 27.5.2024	Mbi miratimin e “Metodologjisë së shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni i energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”...	13800
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 101, datë 27.5.2024	Mbi miratimin e “Procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri–Kosovë”.....	13809
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 107, datë 31.5.2024	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 175, datë 4.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Mali’, me kapacitet të instaluar 1490 kw”.....	13816
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 8762, datë 4.3.2024	Me objekt kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë tregtare “Besa Agro Invest” sh.p.k., me kërkesë të debitorit. Caktimin e administratorit të falimentimit. Vendosjen e masës së sigurimit mbi të gjitha pasuritë e luajtshme, të paluajtshme, si dhe të drejtat e debitorit.....	13817
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 289 (1861), datë 16.4.2024	Për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar të shtetases Sose Gilaj.....	13819

Vendim i Gjykatës së Shkallës së
Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm
Shkodër nr. 152 (970),
datë 27.2.2024

Për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Gjon Kuqaj... 13819



Kërko



Programi i transparencës

Shfletto legjislacionin



KATEGORI

- Arkivi Elektronik i Akteve 41874
- Fletorja Zyrtare e RSH-së 4581
- Buletini i Njoftimeve Zyrtare i RSH-së 380
- Kushtetuta e RSH-së
- Kode të RSH-së
- Përmbledhje legjislacioni
- Treguesit kronologjikë

LIDHJE

- Udhëzues mbi faqen
- ELI
- Kontakte
- Abonime



likimi

Mar

Apr

May

Jun

2024

Me objekt kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë tregtare "Besa Agro Invest" sh.p.k me kërkesë të debitorit. Caktimin e administratorit të falimentimit. Vendosjen e masës së sigurimit mbi të gjithë pasuritë e luajtshme, të drejtat e debitorit.

Tipi i dokumentit :

Vendim (i shkurtuar)

Lloji i aktit : Akt bazë

Permalink ELI:

<http://qbz.gov.al/eli/vendim-i-shkurtuar/2024/03/04/8762>

Nr. i aktit : 8762

Kërko sipas kalendarit

: 04/03/2024

Institucioni përgjegjës :

Gjykata të Rrethëve
Gjyqësore

Fletore Zyrtare nr. :

114

Data e publikimit në

Fletore Zyrtare :

04/07/2024

Fusha e veprimtarisë :

Drejtësi

VENDIM
Nr. 8762, datë 4.3.2024

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë nga:
Antonela Prendi, gjyqtare,
asistuar nga sekretare gjyqësore Aurora Cahani, sot, më datë 4.3.2024, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen civile me nr. 8762 akti, që i përket:
KËRKUES: Shoqëria “Besa Agro Invest” sh.p.k., regjistruar më datë 26.5.2014, me qendër në Fushë-Krujë, Arrameras, nr. pasurie 328/75, vol. 14, f. 209, ZK 1042, NIPT L41726002A, përfaqësuar nga administratori Estref Cekrezi dhe avokati Taulant Naco.
OBJEKTI: Kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë tregtare “Besa Agro Invest” sh.p.k., me kërkesë të debitorit. Caktimin e administratorit të falimentimit. Vendosjen e masës së sigurimit mbi të gjitha pasuritë e luajtshme, të paluajtshme, si dhe të drejtat e debitorit.
BAZA LIGJORE: Nenet 7, 13, 14, 15, 17 të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, “Për falimentimin”. Nenet 41, 42, 153, 334 të KPrC-së.
Gjykata, pasi administroi provat, deklaroi të mbyllur hetimin gjyqësor, dëgjoi konkluzionet përfundimtare të palës kërkuese, e cila kërkoi pranimin e kërkesës dhe si çmoi provat në tërësi,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Hapjen më datë 4.3.2024, ora 15:00, të procedurave të falimentimit për shoqërinë “Besa Agro Invest” sh.p.k., NIPT L41726002A, reregjistruar më datë 26.5.2014, me qendër të ushtrimit të aktivitetit në Durrës, Fushë-Krujë, Arrameras, Rruga e Celeve, Fushë-Krujë, Arrameras, me ortak Fondacionin “Albanian Besa Capital”, me administrator z. Estref Cekrezi, dhe objekt veprimtarie: “Kultivimi i kulturave të ndryshme bujqësore dhe tregtimin e tyre me shumicë dhe me pakicë. Kultivimi i ullirit, vreshtave dhe pemëve frutore, me qëllim tregtimin e produkteve dhe nënprodukteve të tyre me shumicë dhe me pakicë. Prodhimin e farërave dhe të fidanëve dhe tregtimin e tyre. Ngritjen e industrisë përpunuese të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Ngritjen dhe zhvillimin e agroturizmit. Eksperimentimin e teknologjive të reja në kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Import-eksport dhe tregti me shumicë dhe me pakicë të të gjitha prodhimeve bujqësore blegtorale të përpunuara (industrializuara), e të freskëta të gjalla, blerjes së farave, fidanëve, medikamenteve të ndryshme për mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Import-eksport dhe tregti me shumicë dhe me pakicë të makinerive për prodhim bujqësor dhe blegtoral, traktorë, mjete transporti, si dhe linja dhe makineri të përpunimit të produkteve agroushqimore etj. Nxitjen dhe organizimin e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me prodhimin dhe tregtimin e prodhimeve të fermerëve. Konsulencë në fushën e ekonomisë, bujqësisë, blegtorisë dhe ushqimit, duke përfshirë planet e menaxhimit të cilësisë, mjedisit, turizmit dhe agroturizmit.
3. Caktimin si administratore e falimentimit të znj. Shpresë Breçani, atësia Dem, amësia Hajrie, datëlindja 20.3.1964, lindur në Tropojë, banuese në Tiranë, adresa rruga “Panorama” pallati Sara-El, me nr. licence 09 dhe ID G45320378H.
3. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. duhet të paraqesin pretendimet e tyre pranë administratores së falimentimit znj. Shpresa Breçani, brenda 45 ditëve nga publikimi i vendimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. duhet të njoftojnë administratoren e falimentimit Shpresa Breçani për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasurinë e debitorit.
5. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit shoqëria “Besa Agro Invest” sh.p.k. duhet t'i paguajnë dhe shlyejnë ato pranë administratores së falimentimit Shpresa Breçani.

6. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. për raportim të mbahet brenda 60 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

7. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve të tyre.

8. Urdhërohet publikimi i shkurtimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.

9. Një kopje e këtij vendimi t’i komunikohet administratores së falimentimit Shpresa Breçani.

10. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’i komunikohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim njoftimin të gjitha drejtorive rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

11. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’u komunikohet të gjithë bankave të nivelit të dytë në RSH.

12. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’i komunikohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

13. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’i komunikohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

14. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’i komunikohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

15. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’i komunikohet Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

16. Një kopje e këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k. t’i komunikohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

17. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit.

18. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit.

U shpall në Tiranë, më datë 4.3.2024

**GJYQTARE
Antonela Prendi**

Shënim. Vendimi mori formë të prerë, pasi nuk u ankimua më datë 30.5.2024.

Tiranë, më datë 3.6.2024.

Data 11.07.2024

NJOFTIM

- DREJTUAR:**
1. Punonjësve/Ish-Punonjësve të Shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k shoqëri në procedurë falimentimi
 - 2.Kreditorëve të Shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k shoqëri në procedurë falimentimi
 3. Debitorëve të Shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k shoqëri në procedurë falimentimi

- OBJEKTI:**
1. Njoftim për depozitim të pretendimeve dhe të drejtave të siguruar mbi pasuritë e debitorit Brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga shpallja e këtij njoftimi
 2. Kërkesë debitorëve për pagimin dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj shoqërisë “Besa Agro Invest” sh.p.k prane administratores se falimentimit.

Të nderuar,

Shoqëria “Besa Agro Invest” sh.p.k me NUIS L41726002A ka shpallur falimentimin, sipas Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me Nr.Akti 8762 , date 04.03.2024 duke me emeruar mua, Znj. Shpresa Breçani si Administratore Falimentimi për këtë shoqëri.

Nën cilësinë e administratores së falimentimit jam urdhëruar nga Gjykata për të depozituar vendimin e hapjes së procedurës së falimentimit të shoqërisë prane institucioneve perkatëse.

Gjithashtu bazuar në pikën 3, 4 dhe 5 të dispozitivit të Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me Nr.Akti 8762 , date 04.03.2024 njoftohen kreditorët e shoqërisë në procedurë falimentimi “Besa Agro Invest” sh.p.k të paraqesin pretendimet e tyre tek administratori i falimentimit brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga shpallja e këtij njoftimi.

Gjithashtu personat që kanë detyrime ndaj shoqërisë në procedurë falimentimi “Besa Agro Invest” sh.p.k duhet t'i paguajnë dhe shlyejnë ato prane administratores se falimentimit.


Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

Me respekt,

Shpresa BREÇANI

Administratore Falimenti

Licenca nr. 9



NJOFTIM PER PRETENDTIMET E KREDITOREVE TE SHOQERISE NE PROCEDURE FALIMENTIMI "Besa Agro Invest" shpk

[Home](#) / [Posts](#)

[Njoftim-Besa-Agro-Invest-per-pretendimet-e-kreditoreve-11.07.2024](#)

Shkarko!

No comment

Search ...



Te Fundit

[June 12, 2024](#)

[NJOFTIM PER ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SE SHOQERISE NE PROCEDURE FALIMENTIMI "ALSAT" SHA](#)

[read the article](#)

[May 27, 2024](#)

[NJOFTIM PER ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SE SHOQERISE NE PROCEDURE FALIMENTIMI "ALSAT" SHA](#)

VENDIM PER CELJEN E PROCEDURES SE FALIMENTIMIT TE SHOQERISE "BESA AGRO INVEST"

[Home](#) / [Posts](#)

[Vendimi](#) Shkarko!

No comment

Search ...



Te Fundit

June 12, 2024

NJOFTIM PER ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SE SHOQERISE NE PROCEDURE
FALIMENTIMI "ALSAT" SHA

[read the article](#)

May 27, 2024

NJOFTIM PER ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SE SHOQERISE NE PROCEDURE
FALIMENTIMI "ALSAT" SHA

[read the article](#)